

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/25
Datë: 31.10.2018 .

Në bazë të neneve 11, 12.1 dhe 12.2 paragrafi d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008) dhe nenit 22.1 paragrafi 4 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 02/24), **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.10.2018 nxjerrë:

V E N D I M

për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Junikut me numër 02/24 i datës 27.09.2018

I. Me këtë vendim bëhet shfuqizimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Junikut me numër 02/24 i datës 27.04.2018.

II. Gjatë muajit Mars 2018 kanë filluar procedurat për ndryshimin e Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme 2019 dhe pas gjitha procedurave është miratuar në muajin Shtator 2018 në kuvendin Komunal. Me rekomandimin nga komisioni për shqyrtimin e rregulloreve komunale në Ministrinë e Financave, ku kërkohet se kjo rregullore duhet të jetë në harmoni me ligjin e ri të Tatimit në Pronën e Paluajtshme Nr:06/L-005, i cili ka hyrë në fuqi me datën 1.10.2018.(Pasi që është miratuar vendimi i cili po shfuqizohet).

III. Pas shfuqizimit të këtij Vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa të filloj me procedura për hartimin e Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme 2019 në harmoni me ligjin e ri të Tatimit në Pronën e Paluajtshme Nr:06/L-005.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.



Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
4. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesues i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi



Adresa:
Tel.: +386 (0) 49 760 297
<http://rks-gov.net/junik>



**REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK**

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/26

Datë: 31.10. 2018

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 21 paragrafi 21.1 pika h) të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 7 paragrafi 5 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.10.2018 nxjerrë:

V E N D I M

për

miratimin e

Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2019

I. Me këtë vendim miratohet Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2019 /në tekstin e mëtejme Plani/.

II. Plani është dokument publik dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

III. Kuvendi i Komunës së Junikut është i obliguar që ta respektojë dhe zbatojë Planin gjatë vitit 2019.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i miratuar nga pika I. e këtij vendimi.


V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Referencë:	Numër: 2 – 180-1/18
Për/Za/To:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut
Nga/Od/From:	z. Muharrem Krasniqi – kryesues i Grupit të Punës për Hartimin e (projekt) Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2019
Datë/Datum/Date:	03.09.2018
Tema/Subjekat/Subject:	PLAN I PUNËS

Vendi: Komuna e Junikut

Hartuesi: Grupi i Punës për Hartimin e (projekt) Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2019

Lloji i punës: Plan

**“PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË
JUNIKUT PËR VITIN 2019”**

Junik, shtator 2018

Kuvendi i Komunës së Junikut për realizimin e detyrave të tij të punës në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Junikut, Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut dhe ligjet e tjera në Republikën e Kosovës, për vitin 2019 harton këtë:

PLAN PUNE

Hyrje:

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë dhe zgjedhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale (neni 35 paragrafi 35.1 i LVL-së).

Kuvendi i Komunës së Junikut ka për obligim të zbatojë rolin e tij legjislativ dhe drejtues në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjet e tjera të Republikës së Kosovës.

Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2019 është dokument orientues i aktiviteteve të Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2019 duke paraqitur veprime konkrete të planifikuara, me qëllim të përmbushjes së detyrave të tij në fushën e legjislacionit dhe të mbikëqyrjes si dhe të ngritë transparencën dhe llogaridhënien para qytetarëve junikas.

Ky plan mund të pësoj ndryshime varësisht prej nevojave që paraqiten me kalimin e kohës.

a) Si organi më i lartë, Kuvendi i Komunës së Junikut ka për **objektiv** krijimin e kornizës ligjore që definon parametrat brenda së cilës:

1. do të funksionojë administrata (ekzekutivi),
2. do të mbikëqyrë dhe monitorojë aktivitetet e administratës (ekzekutivit) për t'u siguruar se ato janë në përputhje me kornizën ligjore,
3. në bashkëpunim me administratën (ekzekutivin), të vendosë drejtimin strategjik për zhvillimin ekonomik, fizik dhe financiar të Komunës së Junikut, dhe
4. siguron që parimet e një shoqërie demokratike janë të qëndrueshme në mënyrën me të cilën realizon rolin e tij legjislativ dhe drejtues.

b) Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës së Junikut shërben si mjet për ti arritur qëllimet e mëposhtme përmes planifikimit të plotë dhe të kujdesshëm. Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2019:

1. siguron që Kuvendi i Komunës së Junikut po i përmbush obligimet ligjore duke i miratuar të gjitha rregulloret që i parasheh ligji dhe që janë të nevojshme për shfrytëzim efektiv të resurseve të Komunës së Junikut,
2. shërben si një instrument me anë të të cilit Kuvendi i Komunës së Junikut mund të mbikëqyrë punën e administratës (ekzekutivit) përmes dorëzimit të raporteve financiare dhe të performancës,
3. funksionon si mjet që shton gjasat për arritjen e objektivave të Komunës së Junikut përmes ndërtimit të një kornize ligjore të qëndrueshme,
4. ngrit efikasitetin e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut dhe të administratës (ekzekutivit) në përgjithësi, dhe

5. ngrit transparencën e Kuvendit të Komunës së Junikut. (Qytetarët janë të informuar për aktivitetet e planifikuara paraprakisht dhe kështu mund të jenë më të frytshëm në punën e Kuvendit të Komunës së Junikut, në veçanti duke dhënë kontribut në vendimet që kanë rrjedhoja afatgjata dhe të rëndësishme financiare, ekonomike dhe sociale në Komunën e Junikut.)

c) Aktivitetet e planifikuara të Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2019:

Muaji:	Agjenda:	Vërejtje:
janar	1. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim Vendimit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2019; 2. Informatë e kryetarit të Komunës së Junikut lidhur me Planin e punës së ekzekutivit për vitin 2019; 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor për transparencë komunale;	
shkurt	1. Seancë solemne me rastin e ditës së pavarësisë së Republikës së Kosovës (17 shkurt); 2. Shqyrtimi i raportit të performancës së Komunës së Junikut (nga MAPL) për vitin 2018;	
mars	1. Nxjerrja e vendimit për fillimin e plotësim-ndryshimeve të projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2019; 2. Nxjerrja e vendimit për fillimin e plotësim-ndryshimeve të projekt Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa;	
prill	1. Shqyrtimi i raportit financiar të Komunës së Junikut për vitin 2018; 2. Bartja e buxhetit të pa shpenzuar nga viti 2018 në vitin në vitin 2019; 3. Raport i kryetarit të Komunës së Junikut rreth gjendjes ekonomiko-financiare të Komunës së Junikut për periudhën janar-mars 2019; 4. Informatë lidhur me gjendjen e shërbimeve publike në komunën e Junikut;	
maj	1. Seancë solemne me rastin e 106 vjetorit të mbajtjes së Kuvendit të Junikut (21-24 maj); 2. Formimi i Grupit të punës për hartimin e projekt Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2020; 3. Informatë lidhur me Qarkoren Buxhetore 2019/01 të Ministrisë së Financave; 4. Shqyrtimi i Planit të veprimit për transparencë në procesin e hartimit të buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2020;	
qershor		

	1. Seancë solemne me rastin e Ditës së Çlirimit të komunës së Junikut (13 qershor); 2. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2020-2022; 3. Rishikimi i buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2019;	
korrik	1. Raport i kryetarit të Komunës së Junikut rreth gjendjes ekonomiko-financiare të Komunës së Junikut për periudhën janar-qershor 2019; 2. Raport i kryetarit të Komunës së Junikut rreth gjendjes ekonomiko-financiare të Komunës së Junikut për periudhën mars-qershor 2019; 3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim Vendimit për taksat komunale të ndërtimit për vitin 2020; 4. Informatë mbi raportin e performancës së administratës së komunës së Junikut; 5. Informatë lidhur me përfundimin e vitit shkollor 2018/2019;	
gusht	1. Informatë mbi mbarëvajtjen e procesit të korrje-shirjeve në komunën e Junikut; 2. Informatë lidhur me Qarkoren Buxhetore 2020/03 të Ministrisë së Financave; 3. Informatë lidhur me përgatitjet për vitin e ri shkollor 2019/2020;	
shtator	1. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2020; 2. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim-ndryshimeve të projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2020; 3. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim-ndryshimeve të projekt Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa.	
tetor	1. Raport i kryetarit të Komunës së Junikut rreth gjendjes ekonomiko-financiare të Komunës së Junikut për periudhën korrik-shtator 2019; 2. Informatë mbi gjendjen e shëndetit publik në komunën e Junikut; 3. Informatë mbi gjendjen e bizneseve në komunën e Junikut.	
nëntor	1. Informatë lidhur me menaxhimin e pyjeve në territorin e komunës së Junikut (pyjet që menaxhohen nga ana e Komunës së Junikut); 2. Informatë lidhur me zbatimin e rregulloreve komunale dhe dokumenteve strategjike komunale.	
dhjetor	1. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2020; 2. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2020;	

d) Aktivitetet e planifikuara të komiteteve obligative dhe funksionale të Kuvendit të Komunës së Junikut:

- Mbajtja e mbledhjeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme,
- Shqyrtimi i materialeve të propozuara qofshin ato propozim Vendime, projekt Rregullore apo dokumente të tjera strategjike komunale, dhe
- Të gjitha aktivitetet e parapara nën pikën c).

e) Aktivitetet e planifikuara të Grupit të Femrave të Komunës së Junikut dhe grupeve të tjera joformale të Kuvendit të Komunës së Junikut:

f) Afatet për përmbushjen dhe realizimin e aktiviteteve të parapara:



Realizimi i aktiviteteve të parapara me planin e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut do të bëhet brenda dymbëdhjetë muajve të vitit 2019.

g) Kostoja financiare për zbatimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2019 është: ?????

Kuvendi i Komunës së Junikut

Muharrem Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 002/27

Datë: 31.10. 2018

Në bazë të nenit 40.2 germa (e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 25 pika 9 të Statutit të Komunës së Junikut, në mbështetje të nenit 8 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komunë, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.27.09.2018, mori vendim për themelimin e Komitetit Konsultativ të Personave me Afësi të Kufizuara, në bazë të cështjes së më lartë nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E PANELIT PËRZGJEDHËS TË ANËTARËVE TË
KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONAT ME AFËSI TË
KUFIZUAR NË KOMUNËN E JUNIKUT

- I. Themelohet Paneli përzgjedhës i anëtarëve të Komitetit Konsultativ për personat me afësi të kufizuar në Komunën e Junikut, në këtë përbërje:
 1. Sindije Idrizi AAK-PDK këshilltar nga Kuvendi,
 2. Betim Gacaferi AAK-PDK këshilltar nga Kuvendi,
 3. _____ LDK-LVV një këshilltar-e nga Kuvendi,
 4. Venera Shala - nga ekzekutivi,
 5. Nezir Shehu - nga OJQ-ët.
- II. Kryesuesi i Kuvendit e fton takimin e parë të Panelit, në të cilin takim Paneli e zgjedh kryesuesin, nga radhët e veta.
- III. Detyrë e Panelit përzgjedhës është: zhvillimi i procedurës së intervistimit të kandidatëve që konkurrojnë për anëtarë të Komitetit Konsultativ, sipas kriterëve të përcaktuara me konkurs publik.
- IV. Pas përfundimit të procedurave të intervistimit, Paneli harton raportin dhe i propozon Kuvendit të Komunës për aprovim listën me anëtarë për Komitetin Konsultativ për personat me afësi të kufizuar në Komunën e Junikut.



- V. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit.
- VI. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL ,
- Zyra e Kryetarit të Komunës
- Të përmendurit në pikën I,
- Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi





**REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK**

**Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/28
Datë: 31.10.2018 .**

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 22 paragrafi 22.1, pika 2. të Statutit të Komunës së Junikut; dhe nenit 16 paragrafi 11. të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 31.10.2018, nxjerrë:

V E N D I M

për miratimin e

Rregullores për punën e Kuvendit Komunal në Junik

I. Me këtë vendim miratohet Rregullorja për punën e Kuvendit Komunal në Junik /në tekstin e mëtejme Rregullorja/.

II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja e miratuar nga pika I. e këtij vendimi.

III. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut dhe Kuvendi i Komunës së Junikut.


IV. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

- 1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;**
- 2. Kryetari i Komunës së Junikut;**
- 3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe**
- 4. Arkivi i Komunës së Junikut.**





Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova
Kuvendi Komunal – Skupština Opštine – Municipal Assambly
JUNIK

RREGULLORE PËR PUNËN E KUVENDIT TË
KOMUNËS JUNIK

Junik
Tetor 2018,

Në bazë të nenit 12, paragrafët 12.1 dhe 12.2, pika b), dhe nenit 12.4 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008, dt. 4 qershor 2008), Statutit të Komunës së Junikut neni 22 paragrafi 22.1 pika 2, Kuvendi i Komunës së Junikut, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 31.10.2018, miratoi këtë:

PROJEKT RREGULLORE PËR PUNËN E KUVENDIT TË KOMUNËS SË JUNIKUT

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë Rregullore, më afërsisht, përcaktohen rregullat e punës të Kuvendit të Komunës së Junikut, mënyrat e vendosjes, mënyrat e realizimit të të drejtave e përgjegjësi të këshilltarëve, procedurat e pjesëmarrjes së qytetarëve në mbledhje dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e Kuvendit të Komunës, në tekstin e mëtejme Kuvendi.

Neni 2

Me këtë Rregullore, përcaktohet edhe mënyra e thirrjes, organizmit dhe mbajtjes së mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve jashtëzakonshme, miratimi i rendit të ditës, pjesëmarrja në diskutim dhe rregullat për mbarëvajtjen e punës së Kuvendit.

Neni 3

Kuvendi shqyrton dhe vendos çështje për të cilat është kompetent mbi bazën e dispozitave ligjore, Statutin e Komunës dhe dispozitave të tjera nënligjore si dhe çështje të cilat i delegohen nga niveli qendror i Republikës së Kosovës.

Neni 4

Në punën e Kuvendit, gjuhët zyrtare të Komunës përdoren në mënyrë të barabartë.

II. Konstituimi i Kuvendit

1. Mbledhja konstituive e Kuvendit

Neni 5

1. Mbledhja konstituive e Kuvendit, në përbërjen e re, mbahet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e certifikimit të zgjedhjeve.
2. Mbledhjen konstituive e thërret kryetari i Komunës nëse është i zgjedhur dhe i certifikuar.
3. Nëse kryetari i Komunës nuk e thërret mbledhjen konstituive në afatin e paraparë në paragrafin paraprak, mbledhjen e thërret anëtar i mosshuar në përbërjen e certifikuar të Kuvendit.

4. Nëse edhe anëtari më i moshuar nuk e përmbush autorizimin e tij sipas paragrafit paraprak të këtij neni, Mbledhjen konstituive e thërret shumica e anëtareve të certifikuar të Kuvendit me nënshkrim të anëtareve përkatës që bashkëngjitet në aneks të thirrjes së mbledhjes.

Neni 6

Në rast se kryesuesi i Kuvendit nuk zgjidhet në mbledhjen konstituive, deri në zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit, mbledhjet e thërret dhe i kryeson anëtari më i moshuar i Kuvendit.

Neni 7

Rendi i ditës i mbledhjes konstituive, përveç tjerash, përmban:

(skenarin për mbarëvajtjen e mbledhjeve konstituive e përgatit shërbimi i kuvendit)

Hapja dhe kryesimi i mbledhjes nga anëtari më i vjetër i Kuvendit;

1. formimi i komisionit për verifikimin e mandatit të anëtareve të Kuvendit;
2. raporti i komisionit për verifikimin e mandatit të anëtareve të Kuvendit;
3. dhënia dhe nënshkrimi i betimit solemn të anëtareve të Kuvendit;
4. dhënia dhe nënshkrimi i betimit solemn të kryetarit të Komunës;
5. zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit;
6. formimi i Komisionit për mbikëqyrjen e procesit të votimit ;
7. propozimi i kandidatëve;
8. procesi i votimit;
9. raporti i Komisionit për rezultatet e votimit;
10. dhënia dhe nënshkrimi i betimit solemn të kryesuesit të Kuvendit.

Neni 8

Verifikimi i mandatit të anëtareve bëhet mbi bazën e vendimit për certifikim të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 9

Betimi i anëtareve bëhet me ftesë të kryesuesit të mbledhjes së Kuvendit i cili e lexon pjesë – pjesë tekstin, tekst që përsëritet në mënyrë të zëshme nga anëtarët, me të vetmin ndryshim që pas fjalës ku çdo këshilltar e thotë emrin dhe mbiemrin e vet.

Neni 10

Teksti i betimit për anëtarë është:

Unë _____, betohem se do t'i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtrojë autorizimet e mia në cilësinë e anëtarit të Kuvendit të Komunës së _____, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë qytetarët.

Neni 11

1. Anëtari i kuvendit, të drejtat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me dispozita ligjore, Statutin e Komunës dhe këtë Rregullore i fiton ditën e verifikimit të mandatit përkatësisht ditën e dhënies dhe nënshkrimit të betimit solemn.

2. Betimi solemn nënshkruhet nga anëtari dhe kryesuesi i mbledhjes, përkatësisht kryesuesi i Kuvendit.

Neni 12

1. Kryetari i komunës betimin solemn e jep pas konstituimit të Kuvendit.

2. Tekstin e betimit pjesë e lexon kryesuesi i mbledhjes, ndërsa kryetari i Komunës e përsëritë në mënyrë të zëshme.

3. Teksti i betimit për kryetar të Komunës është:

3.1. Unë _____, betohem se do t'i kryej detyrat dhe do t'i ushtroj kompetencat e mia në funksionin e kryetarit të Komunës së _____, me nderë, besnikëri, paanshmëri, ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.

4. Teksti i betimit nënshkruhet nga kryetari i Komunës dhe kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit.

2. Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit.

Neni 13

1. Kuvendi, në afat prej 30 ditësh nga dita e konstituimit, e zgjedhë kryesuesin nga radhët e anëtareve të Kuvendit.

2. Kryesuesi i Kuvendit zgjidhet për mandat të njëjtë të përbërjes së Kuvendit.

Neni 14

1. Kandidatët për kryesues të Kuvendit i propozojnë:

- 1.1. Përfaqësuesit e subjekteve politike në kuadër të përbërjes së Kuvendit,
- 1.2. Një grup i anëtareve apo një anëtar.

2. Propozimi i kandidatëve për kryesues të Kuvendit përmban: Emrin dhe mbiemrin e kandidatit, biografinë e shkurtë, përkatësinë partiake dhe emrin e mbiemrin e propozuesve apo propozuesit.

3. Propozimi i kandidatëve për kryesues të Kuvendit, në parim, bëhet në formë të shkruar dhe i njëjti paraprakisht e më së largu deri në fillim të mbledhjes i dërgohet kryesuesit të mbledhjes së Kuvendit.

4. Propozimi i kandidatëve për kryesues të Kuvendit mund të bëhet edhe në formë gojore gjatë procesit të propozimit të kandidatëve.

Neni 15

Kryesuesi i mbledhjes, përmes Shërbimit të Kuvendit, për anëtar, siguron kopje të mjaftueshme të të gjitha propozimeve të paraqitura në formë të shkruar për kryesuesin e Kuvendit.

Neni 16

1. Për propozimet e kandidatëve, para se të kalohet në procesin e votimit, hapet debati.
2. Propozuesi, gjatë debatit, mund të paraqet arsyetime shtesë për propozimin e kandidatëve apo kandidatit.

Neni 17

1. Lista e fletëvotimit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit, përpilohet sipas renditjes alfabetike të emrave të kandidatëve.
2. Votimi i kandidatëve për kryesues të Kuvendit bëhet me vota të fshehta.

Neni 18

1. Kandidati i cili në votimin e parë merr më shumë se gjysmën e votave nga numri i përgjithshëm i përbërjes së Kuvendit zgjidhet kryesues i Kuvendit.
2. Në rast se, asnjë prej kandidatëve nuk e siguron shumicën e votave sipas paragrafit paraprak të këtij neni, në procesin e dytë të votimit përfshihen vetëm dy kandidatët të cilët në votimin paraprak kanë marrë numrin më të madh të votave.
3. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave nga numri i përgjithshëm i përbërjes së Kuvendit zgjidhet kryesues i Kuvendit.

Neni 19

1. Në rast se edhe në votimin e dytë asnjëri prej kandidatëve nuk merr më shumë se gjysmën e votave nga numri i përgjithshëm i përbërjes së kuvendit, kalohet në votimin e tretë.
2. Në votimin e tretë, kryesues i kuvendit zgjidhet kandidati i cili merr shumicën e votave të numrit të anëtareve të pranishëm dhe që votojnë, për propozimin në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.
3. Nëse edhe pas votimit të tretë nuk zgjidhet kryesuesi i Kuvendit të Komunës, atëherë i tërë procesi për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës përsëritet.

Neni 20

1. Fletëvotimi përmban emblemën zyrtare të komunës, emërtimin për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit, kandidatët sipas radhës dhe nga një katror për deklarimin e votës në vijën horizontale të emrave dhe mbiemrave të kandidatëve, datën, vendin dhe vulën e Kuvendit.

2. Në rast se për kryesues të kuvendit është vetëm një kandidat, përveç elementeve të përcaktuara në nenin paraparak, në fletëvotim shënohet emri dhe mbiemri i kandidatit dhe në vijën horizontale dy katror mbi të cilët shënohet “për” dhe “kundër” për deklarimin e votës së anëtarëve.

Neni 21

Teksti i betimit për kryesues të Kuvendit është:

1. Unë _____, betohem se do t’i kryej detyrat dhe do t’i ushtroj kompetencat e mia në cilësinë e kryesuesit të kuvendit të komunës së _____, me nder, besnikëri, paanshmëri, ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.

3.Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës

Neni 22

1.Kuvendi i Komunës punon në bazë të Planit vjetor të punës.

2.Plani vjetor i punës së Kuvendit përmban:

- 2.1.Objektivat e Kuvendit;
- 2.2.Qëllimet e Kuvendit;
- 2.3.Aktivitetet e planifikuara të Kuvendit;
- 2.4.Aktivitetet e planifikuara të komiteteve obligative dhe funksionale;
- 2.5.Aktivitetet e planifikuara të Grupit të Grave dhe grupeve tjera joformale të Kuvendit;
- 2.6.Afatet për përmbushjen dhe realizimin e aktiviteteve të parapara;
- 2.7.Koston financiare për implementimin e Planit të punës.

3.Nën udhëheqjen e Kryesuesit, Kuvendi i Komunës themelon grupin punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës.

4.Grupi punues, në konsultim me Kryetarin e Komunës, drejtorët komunal, subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend dhe shoqërinë civile, harton draftin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin e ardhshëm kalendarik.

5.Para përfundimit të vitit aktual kalendarik, Kuvendi miraton Planin e punës të Kuvendit të Komunës për vitin e ardhshëm kalendarik.

6.Në seancën e parë të vitit kalendarik, Kryesuesi i paraqet Kuvendit të Komunës raport mbi realizimin e Planit të punës për vitin paraparak kalendarik.

7.Plani i punës i Kuvendit të Komunës publikohet në faqen elektronike të Komunës në gjuhët zyrtare të Komunës.

III. Mbledhjet e Kuvendit

Neni 23

Kuvendi punon dhe vendos në mbledhje.

Neni 24

Kuvendi mban mbledhje të rregullta, sipas nevojës mban edhe të jashtëzakonshme.

Neni 25

Kuvendi gjatë një viti fiskal, është i obliguar të mbajë së paku 10 (dhjetë) prej të cilave 5 (pesë) mbledhje mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit përkatës fiskal.

1. Thirrja e mbledhjes

Neni 26

1. Mbledhjen e Kuvendit e thërret dhe e kryeson, kryesuesi i kuvendit apo anëtar i me i moshuar në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

2. Mbledhja e jashtëzakonshme thirret në rastet kur kryesuesi i Kuvendit e vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme por thirret edhe më kërkesë të kryetarit të komunës si dhe në kërkesë të së paku 1/3 (një të tretës) të numrit të përgjithshëm të përbërjes së Kuvendit.

3. Mbledhjen e kuvendit mund ta thërret edhe shumica e anëtareve nga numri i përgjithshëm i përbërjes së kuvendit.

4. Mbledhja nga paragrafi paraprak i këtij neni thirret, në formë të shkruar, me propozim për shqyrtim të çështjeve konkrete dhe nënshkrim të anëtarëve përkatës.

5. Rendi i ditës i mbledhjes se jashtëzakonshme, mbledhjes të thirrur nga shumica e anëtareve të përbërjes së kuvendit dhe mbledhjes të thirrur në rrethana të jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohet gjatë mbledhjes.

Neni 27

1. Anëtarët e kuvendit njoftohen në formë të shkruar së paku 7 (shtatë) ditë pune para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes, ndërkaq tri ditë pune para mbajtjes së mbledhjes se jashtëzakonshme.

2. Thirrja për mbledhje, përveç tjerash, përmban:

- 2.1. data e mbajtjes së mbledhjes;
- 2.2. koha e fillimit të punës së mbledhjes;
- 2.3. vendi i mbajtjes së mbledhjes;
- 2.4. rendi i propozuar i ditës;
- 2.5. materialet e propozuara për shqyrtim.

Neni 28

Materialet, në mënyrën dhe afatin e përcaktuar në nenin paraprak të kësaj Rregulloreje, i dërgohen edhe kryetarit dhe nënkryetarit të komunës, drejtorëve të drejtorive të Komunës dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Neni 29

Kryesuesi i kuvendit mund të vendosë që materiali i mbledhjeve të kuvendit t'i dërgohet edhe mjeteve të informimit, grupeve të caktuara të interesit dhe subjekteve tjera të interesuara.

Neni 30

1. Kryesuesi i kuvendit, për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit i njofton edhe qytetarët në afatet dhe mënyrat e parapara ligjore.

2. Njoftimi për mbajtjen e mbledhjeve, përveç tjerash, bëhet përmes ;

2.1. tabelës së shpalljeve dhe shpalljeve publike;

2.2. mjeteve lokale të informimit, elektronike dhe të shkruara dhe;

2.3. web faqes zyrtare të Komunës.

2. Hapja e mbledhjes

Neni 31

1. Mbledhjen e kuvendit e hap dhe e udhëheqë kryesuesi i kuvendit.

2. Kryesuesi i kuvendit, përveç tjerash, njofton nëse ndonjë prej anëtareve paraprakisht e ka paralajmëruar mungesën për mbledhjen përkatëse të Kuvendit.

3. Kuorumi

Neni 32

1. Kuorumi ekziston nëse në mbledhje janë të pranishëm 50% +1 anëtarë nga numri i përgjithshëm i përbërjes së Kuvendit.

2. Në rast se gjatë mbajtjes së mbledhjes, kryesuesi i kuvendit, konstaton se nuk ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje e ndërprente mbledhjen dhe e cakton kohën e fillimit të vazhdimit të mbledhjes.

3. Pas çdo pauze, para se të fillohet me punë, verifikohet prezenca përkatësisht numri i anëtareve të pranishëm në mbledhje.

4. Miratimi i rendit të ditës

Neni 33

1. Kryesuesi i Kuvendit njofton dhe jep sqarime të shkurta për çështjet e përfshira në rendin e propozuar të ditës.

2. Kryesuesi i Kuvendit dhe kryetari i Komunës mund të propozojnë që në rend dite të përfshihen edhe çështje të tjera për të cilat në mënyrë urgjente është shtruar nevoja për shqyrtim pas dërgimit të thirrjes përkatësisht rendit të propozuar të ditës dhe materialit për mbledhjen përkatëse.

Neni 34

Komiteti për Politikë dhe Financa, mbi bazën e konstatimeve të miratuara, mund t'i rekomandojë Kuvendit që ndonjë çështje të hiqet nga rendi i ditës apo rendi i ditës të plotësohet me ndonjë çështje konkrete, me arsyetim të rekomandimit përkatës.

Neni 35

Grupet e anëtareve, anëtarët dhe përfaqësuesit e trupave punues të Kuvendit përkatësisht komiteteve dhe komisioneve e kanë të drejtën të propozojnë ndryshimin apo plotësimin e rendit të ditës me arsyetim të shkurt të propozimit të paraqitur.

Neni 36

1. Propozimet për ndryshimin apo plotësimin e rendit të ditës, në parim, bëhen në formë të shkruar dhe i dërgohen kryesuesit të Kuvendit më së voni deri në fillim të mbledhjes.
2. Kuvendi vendos veç e veç për çdo propozim për ndryshimin apo plotësimin e rendit të ditës.
3. Së pari, sipas radhës së paraqitur, shqyrtohen propozimet që ndonjë çështje e propozuar të hiqet nga rendi i ditës.
4. Propozimet për plotësimin e rendit të ditës bëhen në analogji sipas mënyrës së përcaktuar në paragrafin paraprak të këtij neni.
5. Propozimi bazë qitet në votim i pari.

Neni 37

1. Për propozimet lidhur me ndryshimin apo plotësimin e rendit të ditës nuk hapet debat, por pas arsyetimeve të shkurta të propozuesit dhe sqarimeve të kryesuesit të Kuvendit, përfaqësuesit të Ekzekutivit apo propozuesit të çështjes konkrete, kalohet në votim.
2. Rendi i propozuar i ditës, në tërësi, miratohet me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

5. Shqyrtimi i çështjeve në mbledhje të Kuvendit

Neni 38

1. Në mbledhje të Kuvendit çështjet shqyrtohen sipas radhës së përcaktuar në rendin e miratuar të ditës.
2. Sipas nevojës, në propozim të kryesuesit të Kuvendit, shefit të grupit të anëtarëve, apo anëtareve, Kuvendi përmes votimit mund të vendos për bashkimin e dy apo më shumë çështjeve për shqyrtim të njëkohshëm apo ndryshimin e radhës për shqyrtimin e çështjeve përkatëse.

6. Debat i gjatë shqyrtimit të çështjeve

Neni 39

1. Kryesuesi i kuvendit është i obliguar që të respektojë parimin e të drejtës së barabartë për diskutim dhe pjesëmarrje aktive të anëtarëve në punën e Kuvendit.
2. Kryesuesi i kuvendit, të interesuarve fjalën ua jep sipas radhës së paraqitur për diskutim.
3. Pjesëmarrësit në mbledhje për pika të caktuara në kuadër të rendit të ditës, për diskutim mund të paraqiten edhe para fillimit të mbledhjes.
4. Evidencën e radhës së paraqitjes për diskutim para fillimit të mbledhjes e mban zyrtari i autorizuar i shërbimit të kuvendit.

Neni 40

1. Për çdo çështje, në kuadër të rendit të ditës, paraprakisht jepet fjala hyrëse nga propozuesi i çështjes konkrete në kohëzgjatje deri 10 minuta.
2. Pas fjalës hyrëse, kryesuesi i Kuvendit, fillimisht fjalën ua jep shefave të grupeve të anëtarëve, në kohëzgjatje deri 10 minuta, më pastaj fjala iu jepet anëtarëve përkatësisht pjesëmarrësve të tjerë në kohëzgjatje deri 5 minuta në paraqitjen e parë.
3. Sqarimet plotësuese apo diskutimi për herë të dytë, në kuadër të një pike të rendit të ditës, lejohet vetëm pas përfundimit të të gjithë të paraqiturve për diskutim dhe atë në kohëzgjatje deri 3 minuta.

Neni 41

Shefit të grupit të anëtarëve apo anëtarit i cili e kërkon fjalën lidhur me shkeljen e dispozitave të kësaj Rregulloreje, fjala i jepet menjëherë.

Neni 42

1. Gjatë shqyrtimit të një çështjeje apo propozimi konkret nuk lejohen propozime të tjera, përveç :
 - 1.1. propozimit për ndryshime dhe modifikime.
 - 1.2. propozimit për të parandaluar çrregullimin e punës së mbledhjes.

1.3. propozimit që çështja konkrete të kompletohet me të dhëna shtesë dhe çështja të shtyhet për shqyrtim për mbledhje të radhës së Kuvendit.

1.4. propozimit që debati i mëtejshëm apo vazhdimi i mbledhjes të mbahet i mbyllur.

1.5. propozimit për ndërprerjen e debatit dhe vendosjen e çështjes përmes votimit,

1.6. propozimit për ndërprerje të mbledhjes.

Neni 43

1. Në rast se gjatë debatit përmendet në mënyrë të drejtpërdrejtë emri i ndonjë diskutuesi, është e lejuar replika në kohëzgjatje deri 1 minuta.

2. Replika ndaj replikës është e lejuar në kohëzgjatje deri 1 minuta.

3. Replika vijuese nuk është e lejuar përveç rasteve nëse kryesuesi Kuvendit e vlerëson të arsyeshme dhe të njëjtën e lejon dhe atë në kohëzgjatje deri 1 minuta.

Neni 44

1. Kryesuesi i Kuvendit, gjatë shqyrtimit të çështjeve, sipas vlerësimit të tij apo mbi bazën e propozimeve, në rast se janë të nevojshme konsultimet në kuadër të grupeve të anëtarëve, konsultimet me propozuesin e çështjes për të cilën debatohet apo çfarëdo konsultimesh të tjera, mund ta ndërprejnë përkohësisht mbledhjen dhe njëkohësisht e cakton kohën e vazhdimit të mbledhjes.

2. Në rast se kryesuesi i Kuvendit nuk e përkrah propozimin për ndërprerjen e përkohshme të mbledhjes, për propozimin e dhënë Kuvendi vendos me votim, të shumicës anëtarëve të pranishëm.

Neni 45

Përfaqësuesit e organeve dhe drejtorive komunale, përkatësisht propozuesve të materialeve, për çështjet e shtruara gjatë debatit, sqarimet plotësuese i paraqesin pas përfundimit të diskutimeve të të gjithë të paraqiturve për diskutim.

7. Vendosja dhe miratimi i çështjeve

Neni 46

1. Kuvendi, çështjet i vendos dhe i miraton në mbledhje në të cilat ekziston kuorumi me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, nëse me dispozita ligjore, Statutin e Komunës dhe këtë Rregullore nuk është paraparë ndryshe.

2. Votimi, në parim është i hapur përveç për çështjet e caktuara me dispozita ligjore, Statutin e Komunës dhe këtë Rregullore.

3. Votimi i hapur bëhet me ngritje të dorës.

4. Në procesin e votimit, e drejtë personale e anëtarit është që çështjen e caktuar ta përkrah, të jetë kundër ose abstenoj.

5. Në procesverbal shënohen emrat e anëtareve të cilët nuk kanë votuar fare.

Neni 47

Në fund të debatit çështjet e shqyrtuara të rendit të ditës, kryesuesi i Kuvendit i përfundon me rezyme të shkurtë dhe konstatime mbi bazën e diskutimeve të zhvilluara dhe i paraqet rezultatet numerike të votimit përkatësisht konstaton se propozimi apo çështja konkrete a është miratuar apo nuk është miratuar.

8. Pyetja e anëtarit

Neni 48

1. Anëtari e ka të drejtën që në mbledhje të Kuvendit t'i shtrojë pyetje kryesuesit të Kuvendit, kryetarit të komunës dhe drejtorëve të drejtorive të Komunës për të gjitha çështjet në kompetencë të tyre.

2. Pyetjet dhe kërkesat e anëtareve të kuvendit parashtrohen pas miratimit të procesverbalit.

Neni 49

1. Anëtari, në një mbledhje, mund të shtrojë më së shumti dy pyetje.

2. Kohëzgjatja për një pyetje është deri 1 minutë.

3. Pyetja e anëtarit paraqitet gojarisht dhe dorëzohet në formë të shkruar.

4. Për pyetjen e anëtarit nuk hapet debat.

Neni 50

1. Përgjigjja në pyetjen e anëtarit, në parim, jepet në formë të shkruar para fillimit të mbledhjes së radhës të kuvendit, por mund të jepet edhe menjëherë pas parashtrimit të pyetjes.

2. Lidhur me përgjigjen e dhënë, anëtari i cili e ka shtruar pyetjen e ka të drejtën të shtrojë pyetje plotësuese në kohëzgjatje deri 1 minutë.

3. Përgjigjja mund të jepet menjëherë në formë gojore ose në formë të shkruar para fillimit të mbledhjes së radhës të Kuvendit.

9. Procesverbali

Neni 51

1. Për punën e Kuvendit mbahet procesverbal.

2. Mbi bazën e procesverbalit nxirret Ekstrakti i procesverbalit i cili, përveç tjerash, përmban datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, kohën e fillimit, emrin, mbiemrin dhe funksionin e udhëheqësit apo kryesuesit të mbledhjes, pjesëmarrësit, pikat e rendit të ditës, esenca e shkurt e diskutimeve me konstatimet përkatëse, rezultatet numerike të votimit për çështjet e shqyrtuara dhe kohën e mbarimit të mbledhjes.

3. Anëtari, pjesëmarrës në mbledhje, ka të drejtë të kërkojë që diskutimi i tij apo një pjesë e diskutimit, në ekstraktin e procesverbalit të evidentohet në formë të shkurtë në mënyrën në të cilën ai e paraqet çështjen konkrete.

4. Grupi i anëtarëve apo anëtari mund të kërkojnë që në ekstrakt të procesverbalit të evidentohet veçimi i tyre gjatë votimit në çështje të caktuara.

5. Lista e nënshkruar e anëtareve pjesëmarrës në mbledhje është pjesë përbërëse e Ekstraktit të procesverbalit.

Neni 52

1. Mbledhjet e kuvendit regjistrohen në mënyrë tonike.

Neni 53

1. Ekstrakti i procesverbalit, në parim, miratohet në mbledhjen e radhës të Kuvendit.

2. Anëtari mund të paraqet vërejtje dhe të kërkojë të bëhen ndryshime dhe plotësime përkatëse në ekstrakt të procesverbalit. Vërejtjet paraqiten gojarisht dhe dorëzohen në formë të shkruar.

3. Për arsyesh mërinë e vërejtjeve, sipas paragrafit paraparak të këtij neni, vendoset pa debat.

4. Në rast të mospajtimeve eventuale, të qëndrueshme janë vërejtjet të cilat verifikohen në regjistrimin tonik të mbledhjes.

5. Ekstrakti i procesverbalit, pas miratimit së bashku me vërejtjet dhe plotësimet eventuale, nënshkruhet nga kryesuesi i Kuvendit përkatësisht kryesuesi i mbledhjes.

IV. Rregullat për mbarëvajtjen e punës në mbledhje

Neni 54

Në mbledhje të kuvendit, askush nuk mund të del në foltore dhe as të diskutoj pa iu dhënë fjala parapraakisht nga kryesuesi i Kuvendit.

Neni 55

1. Anëtarët dhe pjesëmarrësit të tjerë në mbledhje, gjatë diskutimeve, janë të obliguar t'i përmbahen çështjes e cila shqyrtohet në kuadër të rendit të ditës, të respektojnë dinjitetin dhe autoritetin e anëtarëve, udhëheqësve të organeve dhe institucioneve të

Komunës, të pranishmëve në mbledhje si dhe personave të tjerë që ndërlidhen me çështjen për të cilën debatohet.

2. Gjatë debatit nuk janë të lejuara shprehjet ofenduese, nënçmuese dhe paraqitja e të dhënave nga jeta private e askujt.

3. Gjatë punës përkatësisht debatit, nga anëtarët dhe pjesëmarrësit të tjerë në mbledhje ndalohet ndërhyrja, ndërprerja apo pengimi në çfarëdo mënyre të diskutuesit përderisa i njëjti e përfundon fjalën e tij.

Neni 56

1. Në rast se ndonjë prej anëtarëve apo pjesëmarrësve në mbledhje nuk iu përmbahet rregullave të përcaktuara për mbarëvajtjen e punës së mbledhjes, kryesuesi i Kuvendit, sipas vlerësimit të rastit, mund të shqiptojë masat tërheqje e vërejtjes dhe marrje të fjalës si dhe mund të propozojë masën largim nga mbledhja.

2. Masa tërheqje e vërejtjes i shqiptohet anëtarit dhe pjesëmarrësit tjetër në mbledhje i cili nuk iu përmbahet rregullave të parapara në nenet 55.1, 56.1, 56.2 dhe 56.3 të kësaj Rregulloreje apo në çfarëdo mënyre tjetër e pengon mbarëvajtjen e punës së mbledhjes.

3. Masa marrje e fjalës, i shqiptohet anëtarit apo pjesëmarrësit tjetër i cili gjatë diskutimit nuk e përfill masën tërheqje e vërejtjes të shqiptuar nga kryesuesi i Kuvendit dhe me sjelljen e tij vazhdon të shkel rregullat për mbarëvajtjen e mbledhjes.

4. Masa largim nga mbledhja, i shqiptohet anëtarit përkatësisht pjesëmarrësit tjetër i cili nuk iu përmbahet masave të shqiptuara nga kryesuesi i Kuvendit, tërheqje e vërejtjes ose marrje e fjalës dhe në rastet kur me sjelljet e tyre shkelin dispozitat e kësaj Rregulloreje.

5. Për marrjen e masës largim nga mbledhja të anëtarit apo pjesëmarrësit tjetër vendos Kuvendi, pa debat, me votat e shumicës së anëtareve të pranishëm në mbledhje.

6. Masa e shqiptuar largim nga mbledhja vlen vetëm për mbledhjen përkatëse.

V. Kompetencat dhe përgjegjësitë e kryesuesit të kuvendit

Neni 57

1. Kryesuesi i Kuvendit:

1.1. thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit

1.2. në konsultim me kryetarin e Komunës propozon rendin e ditës për mbledhje të Kuvendit

1.3. kujdeset për organizmin dhe mbarëvajtjen e mbledhjeve të kuvendit

1.4. përfaqëson Kuvendin

1.5. është përgjegjës për zbatimin e Rregullores së Punës të Kuvendit

1.6. kujdeset për koordinimin e punëve të trupave ndihmëse të kuvendit përkatësisht komiteteve dhe komisioneve të kuvendit

1.7. është përgjegjës për transparencën e punës së Kuvendit.

1.8. nënshkruan aktet e miratuara në Kuvend

1.9. bashkëpunon me kryetarin e komunës në bashkërendimin e aktiviteteve për punë më të mirëfilltë të Kuvendit

2. Kryen edhe punë të tjera në pajtim me dispozitat ligjore, Statutin e komunës dhe këtë Rregullore.

Neni 58

1. Kryesuesit të kuvendit, para skadimit të mandatit për të cilin është zgjedhur i pushon funksioni në kushtet e parapara me dispozita ligjore dhe Statutin e komunës.

2. Në rast të pushimit të mandatit, për çfarëdo arsye të kryesuesit të Kuvendit, mbledhja për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit thirret më së largu në afatin prej 30 ditësh nga dita e lirimit të postit përkatës.

3. Mbledhjen nga paragrafi paraprak i këtij neni e thërret anëtari më i vjetër apo anëtari të cilin e cakton kuvendi në mbledhjen kur konstatohet pushimi i mandatit të kryesuesit të Kuvendit.

VI. Pjesëmarrja e publikut në mbledhje

Neni 59

1. Mbledhja e Kuvendit është publike. Në mbledhje të kuvendit, mund të merr pjesë publiku pa ndonjë kufizim përpos kufizimeve hapësinore bazuar në nenin 45 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

2. Nëse interesimi i publikut për pjesëmarrje në mbledhje është shumë i madh në raport me mundësit hapësinore, pjesëmarrësit (publiku) caktojnë përfaqësuesin e tyre që të bëjë marrëveshje me kryesuesin e mbledhjes për numrin e publikut që do të merr pjesë në mbledhje.

3. Publiku duhet të ulet dy rende pas anëtarëve të Kuvendit Komunal.

4. Kryesuesi i Kuvendit, vendos për pjesëmarrje të publikut, në paraqitjen e pyetjeve drejtuar Kuvendit si dhe ndërprerjen e pyetjeve të njëjta dhe të zgjatura.

5. Publiku nuk ka të drejtë në ndërhyrje apo propozime. Publiku dhe mediat, mundë të mos marrin pjesë në tërë mbledhjen apo në një pjesë të saj, nëse pjesëmarrja e tyre është e dëmshme për interesat publike.

VII. Të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarit

Neni 60

1. Anëtari e ka të drejtën dhe përgjegjësinë e pjesëmarrjes, diskutimit dhe propozimit për shqyrtim të çështjeve të caktuara në mbledhje të Kuvendit me mundësi të barabartë në vendosje dhe ushtrimin e kompetencave në pajtim me dispozitat ligjore, Statutin e komunës dhe këtë Rregullore.
2. Anëtari mund të kërkojë nga kryesuesi i kuvendit, kryesuesi i komiteteve apo komisioneve të kuvendit dhe ekzekutivit informacione dhe sqarime të cilat i nevojiten për ushtrimin e funksionit të anëtarit.
3. Gjithashtu anëtari e ka të drejtën që në vijimësi të informohet për të gjitha çështjet me rëndësi nga fushë veprimtaria e kuvendit, ekzekutivit dhe komunës në përgjithësi.
4. Anëtari e ka të drejtën e pjesëmarrjes në mbledhjet e të gjitha trupave punues të Kuvendit, por pa të drejtë vote.

Neni 61

1. Anëtarit i lejohet mungesa nga vendi i punës për gjithë kohën apo periudhën kohore të nevojshme për ushtrimin e funksionit të tij në punët dhe aktivitetet e kuvendit.
2. Për ditën apo periudhën kohore në të cilën është i angazhuar në punët dhe aktivitetet e Kuvendit, lidhur me arsyetimin për mungesën e tij në vendin e punës, anëtarit i lëshohet vërtetimi përkatës.

Neni 62

1. Në të gjitha mbledhjet e kuvendit është e obliguar pjesëmarrja e anëtarit, përveç rasteve të arsyeshme për mospjesëmarrjen e tij.
2. Në rast të pengesave të arsyeshme, anëtari paraprakisht e njofton kryesuesin e Kuvendit për mospjesëmarrjen e tij në mbledhjen përkatëse të kuvendit.

Neni 63

Anëtari është i obliguar të ruajë sekretet dhe të dhënat e natyrës së besueshme që i dërgohen në formë të shkruar si dhe ato për të cilat debatohet në mbledhjet e kuvendit.

Neni 64

1. Anëtarit i jepet kartela identifikuese.
2. Kartela identifikuese, përveç emblemës zyrtare të Komunës, përmban: Emrin, mbiemrin, datëlindjen dhe foton e anëtarit si dhe datën e lëshimit, afatin e vlerëshmërisë dhe numrin e kartelës.

3. Në rast të shuarjes të cilësisë së anëtarit, i njëjti është i detyruar ta kthejë kartelën identifikuese.

4. Evidencën e dhënies së kartelave identifikuese të anëtarit e mban Shërbimi i Kuvendit.

VIII. Renditja e anëtarëve të Kuvendit

Neni 65

1. Anëtarët e Kuvendit, sipas subjektit politik që i përkasin, ulen në ulëset në të cilat janë përcaktuar si rezultat i marrëveshjes së kryesuesve të subjekteve politike dhe Kryesuesit të Kuvendit.

2. Secili anëtar duhet ta ketë të shkruar me shkronja të dukshme emrin dhe mbiemrin në tavolinën para vetes.

3. Këshilltarët e Kryetarit të Komunës (Drejtorët e Drejtorive), ulen në ballinën e Sallës së Kuvendit, të cilët gjithashtu duhet ta kenë të shkruar emrin, mbiemrin dhe drejtorinë që përfaqëson me shkronja të dukshme në tavolinë para vetes.

IX. Shuarja e mandatit të anëtareve

Neni 66

1. Funkcioni i anëtarit shuhet në pajtim me dispozitat ligjore dhe dispozitat nënligjore.

2. Kuvendi informohet se janë plotësuar kushtet për shuarjen e mandatit të anëtarit përkatës.

Neni 67

1. Në rast të lirimit të ndonjë vendi në përbërjen e Kuvendit, kryesuesi i Kuvendit në afat prej 7 (shtatë) ditë pune e njofton Komisionin Komunal Zgjedhor për inicimin e procedurës për zëvendësimin e anëtarit të cilit i ka pushuar mandati.

2. Verifikimi i mandatit të anëtarit i cili e plotëson vendin e lirë gjatë mandatit përkatës të Kuvendit bëhet në mënyrën e përcaktuar në nenin 8.1 të kësaj Rregulloreje.

X. Konflikti i interesit

Neni 68

Anëtari përjashtohet nga pjesa e mbledhjes së kuvendit me rastin e debatit dhe votimit lidhur me çfarëdo çështjesh për të cilat ai apo ndonjë anëtar i familjes së tij të ngushtë kanë ndonjë interes personal apo financiar.

Neni 69

1. Anëtari nuk mund të merr pjesë e as të jetë i pranishëm në asnjë fazë përgatitore, duke përfshirë punën e komiteteve dhe komisioneve të Kuvendit, në të cilat është

anëtar apo komiteteve dhe komisioneve në të cilat nuk është anëtar por e ka të drejtën e pjesëmarrjes në mbledhje, që kanë të bëjnë me çështje në të cilat ai apo anëtar i familjes së tij të ngushtë, e kanë ndonjë interes personal apo financiar.

2. Anëtar, në rast të konfliktit të interesit, është i obliguar që kryesuesin e kuvendit ta njoftojë në formë të shkruar në afat prej 3 (tri) ditësh pasi të bëhet në dijeni apo të informohet për çështjen përkatëse.

XI. Grupet e anëtareve

Neni 70

1. Anëtalet e kanë të drejtën e themelimit të grupeve të anëtareve
2. Grupin e anëtareve, në parim, e përbëjnë anëtalet e një subjekti politik apo të një koalicioni politik.
3. Grupi i anëtareve përbëhet prej së paku (3) tre anëtareve.
4. Anëtar mund të jetë anëtar vetëm i një grupi të anëtarëve.
5. Grupin e anëtarëve e përfaqëson shefi i grupit.
6. Në mungesë të shefit të grupit të anëtareve të njëjtin e zëvendëson anëtar i cili e autorizon grupi përkatës i anëtareve.
7. Grupi i anëtareve mund të autorizoj një prej anëtareve që të njëjtin ta përfaqësoj në çështje të caktuara të cilat shqyrtohen në kuadër të rendit të ditës në mbledhje të Kuvendit, apo në aktivitete të tjera që janë të ndërlidhura me punën e Kuvendit.

Neni 71

1. Kryesuesin e Kuvendit, subjektet politike e njoftojnë në formë të shkruar për përbërjen, përkatësinë partiakë apo iniciativave qytetare dhe shefin i cili e përfaqëson grupin përkatës të anëtareve.
2. Shefi i grupit të anëtareve në formë të shkruar e njofton kryesuesin e kuvendit në rast të ndryshimit të përbërjes apo përfaqësimit të grupit të anëtareve.

XII. Trupat punues të kuvendit

Neni 72

1. Kuvendi, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të veta, në funksion të efikasitetit në lëmi të caktuara për përgatitjen e rekomandimeve, akteve të ndryshme dhe dhënien e propozimeve në çështje konkrete në lëmi përkatëse, përveç trupave të përhershëm obligativ, ngritë edhe trupa tjerë punues të përhershëm, të përkohshëm dhe trupa punues ad hoc.

2. Trupat e përhershëm punues janë komitetet obligative, komitetet e përhershme dhe komitetet konsultative.

3. Trupat e përkohshëm punues dhe trupat ad hoc janë komisionet, janë trupa të cilat i formon kuvendi për shqyrtimin e çështjeve të caktuara.

Neni 73

1. Komitetet obligative dhe komitetet e përhershme shqyrtojnë dhe propozojnë politikat e Kuvendit në lëmi të caktuara dhe pas miratimit në Kuvend përcjellin zbatimin e tyre.

2. Komitetet japin vlerësime, vërejtje, plotësime dhe sugjerime në materialet të cilat shqyrtohen në Kuvend, propozojnë akte të nevojshme dhe iniciojnë çështje në interes për Komunën.

Neni 74

1. Kuvendi, në funksion të përfshirjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, ngritë Komitetet konsultative për lëmi të caktuara.

2. Komitetet konsultative, në lëmi përkatëse, bëjnë hulumtime, japin propozime dhe ofrojnë vlerësime lidhur me iniciativat e kuvendit të komunës.

Neni 75

1. Kuvendi, në fillim të mandatit, me vendim të veçantë i ngritë komitetet e obliguara dhe komitetet e tjera të përhershme mbi bazën e propozimit të grupeve të anëtareve për numrin, strukturën dhe përbërjen e tyre.

2. Struktura e komiteve, nëse nuk parashihet ndryshe me dispozita ligjore dhe dispozita nënligjore, ngritët në proporcion me përqindjen përkatësisht numrin e anëtareve të subjekteve politike apo koalicioneve të përfaqësuara në Kuvend.

3. Komitetet, sipas këtij neni, ngritën në kohëzgjatje të mandatit përkatës të kuvendit.

4. Kuvendi, sipas nevojës, mund të ngritë edhe Komitet konsultativ ad hoc.

Neni 76

Anëtari, mund të jetë anëtar i më së shumti dy komiteve.

Neni 77

1. Për propozimin e përbërjes së komitetit votohet me vota të hapura.

2. Komiteti ngritët me vota të shumicës së anëtarët të pranishëm në mbledhje.

3. Në rast se në votimin e parë nuk miratohet përbërja e propozuar e komitetit përkatës, votimi përsëritet me mundësi që propozuesit paraprkasht të ndryshojnë propozimet e tyre.

4. Nëse në votimin e përsëritur nuk miratohet përbërja e propozuar, kalohet në votim veç e veç për secilin anëtar përkatësisht kryetar dhe zëvendëskryetar të komitetit përkatës.

5. Për anëtarin përkatësisht kryetarin apo zëvendëskryetarin, i cili nuk i merr votat e nevojshme, kalohet në propozime të tjera dhe votim në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 78

1. Komisionet e përkohshme ngritën për hulumtimin, analizimin dhe identifikimin e zgjidhjeve më funksionale për një apo disa çështje për të cilat është e nevojshme angazhim dhe punë në periudhë të caktuar kohore dhe përgatitjen e propozimeve konkrete për shqyrtim në Kuvend të çështjeve përkatëse.

2. Komisionet ad hoc ngritën për vlerësim gjithëpërfshirës të një çështjeje konkrete dhe përgatitjen e propozimit për shqyrtim në Kuvend.

Neni 79

Komisionet e përkohshme dhe Komisionet ad hoc ngritën në analogji me ngritjen e Komiteteve të përhershme dhe mandati i tyre pushon me rastin e miratimit të çështjeve në Kuvend për të cilat janë ngritur.

Neni 80

1. Në pajtim me dispozitat ligjore, Statutin e Komunës dhe këtë Rregullore miratohet Rregullorja për kompetencat, përgjegjësit dhe punën e komiteteve dhe komisioneve të Kuvendit.

2. Komitetet dhe komisionet të cilat nuk përfshihen në rregulloren sipas paragrafit paraprak të këtij neni, përbërja dhe kompetencat e tyre përcaktohen në vendimin me të cilin ngritën.

XIII. Dispozitat përfundimtare

Neni 81

Zbatimin e rregullores e bënë Kuvendi i Komunës.

Neni 82

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja e punës së Kuvendit e datës: 02.04.2013.


Neni 83

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pune pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe pas publikimi në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Datë:31.10.2018

Kryesuesi i Kuvendit
Muhamet Ibrahimi





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/29
Datë: 31.10.2018 .

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2, pika (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 22 paragrafi 22.1, pika 3 . të Statutit të Komunës së Junikut; dhe nenit 16 paragrafi 11. të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 31.10.2018, nxjerrë:

V E N D I M

për miratimin e

Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve

I. Me këtë vendim miratohet Rregullorja për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve/ në tekstin e mëtejme Rregullorja/.

II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja e miratuar nga pika I. e këtij vendimi.

III. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut ,

IV. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

- 1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;**
- 2. Kryetari i Komunës së Junikut;**
- 3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe**
- 4. Arkivi i Komunës së Junikut.**

Kryesuesi i Kuvendit
z. Muhareme Krasniqi





Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova

Kuvendi Komunal – Skupština Opštine – Municipal Assambly

JUNIK

RREGULLORE
PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SË SUBVENCIONEVE

Junik Tetor 2018

Në bazë të nenit 12, paragrafët 1 dhe 2, pika c, të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008, dt. 4 qershor 2008), neni 17 par. 1 dhe 2, i Ligjit nr. 03/L-048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe në zbatim të nenit 36, par. 3, të Rregullës financiare nr. 01/2013 – MF - Shpenzimi i parave publike, dhe të nenit 22, pika 3 të Statutit të Komunës së Junikut Nr. 001/3127, të datës 29.10.2010, Kuvendi i Komunës së Junikut, në mbledhjen e mbajtur më datë: 31.10.2018, miratoi këtë

RREGULLORE

PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat të cilat i mundësojnë Komunës të ndajë mjete financiare pa kthim nga kategoria e subvencioneve për fushat e cekura në këtë rregullore për personat fizik dhe juridik.
2. Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen nga organet dhe trupat komunale gjatë ndarjes së subvencioneve për përfituesit.

Neni 2

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1. Subvencionet - për kuptim të kësaj rregullore subvencionet përfshijnë transferet e njëanshme, të pakthyeshme të mjeteve buxhetore të institucionit, në llogarinë rrjedhëse të përfituesve, të ardhurat e të cilëve nuk mbulojnë shpenzimet e caktuara përkatëse për arritjen e një qëllimi të ligjshëm për interes publik;
 - 1.2. Pagesa e pakthyeshme - është e njëanshme atëherë kur nuk ka mallra dhe shërbime që rrjedhin si kompensim ose kundërvlerë për pagesën;
 - 1.3. Përfituesi - nënkupton personat fizik dhe juridik që përfitojnë mjete financiare nga kategoria e subvencioneve të planifikuara në Buxhetin e Komunës dhe në pajtim me Ligjin për ndarjet buxhetore; dhe
 - 1.4. Banor rezident - nënkupton personi që jeton dhe vepron në Komunë dhe posedon dokumentacion valid të Republikës së Kosovës.

Neni 3

Limitet buxhetore

1. Komuna ndan subvencione duke u bazuar në Ligjin e buxhetit për vitin fiskal për të cilën ndahen subvencionet dhe vetëm në masën e përcaktuar në këtë ligj.
2. Ndarja e subvencioneve për OJQ-të do të bëhet në përputhje me nenin 2 pika 5 të Rregullores MF-Nr-04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
3. Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat të cilat i mundësojnë Komunës të ndajë mjete financiare pa kthim nga kategoria e subvencioneve për fushat e cekura në këtë rregullore për personat fizik dhe juridik.

Neni 4

Rregullat e përgjithshme të aplikimit për subvencione

1. Komuna mund të bëjë ndarje të subvencioneve për persona fizik dhe juridik mbi bazën e kërkesës së tyre dhe në pajtim me dispozitat e kësaj rregullore.
2. Personi fizik dhe juridik mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga Komuna nëse i ka të përfunduara obligimet ndaj Komunës.
3. Kushtëzimi me përfundimin e obligimeve ndaj institucioneve tjera të personit fizik dhe juridik mund të përcaktohet sipas fushave specifike nga vetë Komuna.

Neni 5

Procedurat e përgjithshme për ndarjen e subvencione

1. Procedura e ndarjes së subvencioneve nga Komuna mund të zhvillohet mbi bazën e thirrjes publike apo në raste të veçanta në bazë të kërkesës së arsyetuar atëherë kur lejohet me dispozitat e kësaj rregulloreje.
2. Gjatë ndarjes së subvencioneve përmes thirrjes publike të Komunës përcaktohet qartë fusha e subvencionimit, kriteret, dokumentet e nevojshme për aplikim dhe informata tjera me rëndësi.
3. Shqyrtimi i kërkesave dhe ndarja e subvencioneve mbi bazën e thirrjes publike zhvillohet sipas dispozitave të parapara të kësaj Rregulloreje.
4. Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave për ndarje të subvencioneve jashtë thirrjes publike të Komunës bëhet brenda 15 ditëve të punës nga parashtrimi i kërkesës.

Neni 6

Përrjashtimet nga ndarja e subvencioneve

1. Përrfitues të subvencioneve të ndara nga Komuna nuk mund të jenë personat fizik jo rezident të Komunës.
2. Personi fizik apo juridik vetëm një herë në vit mund të jetë përrfitues i subvencioneve të ndara nga Komuna.
3. Përrjashtim nga paragrafi 2 i këtij Neni bëjnë subvencionet e ndara për persona fizik në fushën e shëndetësisë dhe për nevoja ushqimore (mirëqenie sociale).
4. Nëse me fajin e përrfituesit nuk përmbushen obligimet e përcaktuara në vendimin apo me marrëveshjen për ndarjen e subvencioneve, për 3 (tre) vitet e ardhshme përrfituesi humb të drejtën në përrfitim nga secila kategori e subvencioneve.

Neni 7

Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve

1. Kryetari i Komunës emëron komisione të përkohshme për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve në përbërje të përfaqësuesve nga fushat specifike.
2. Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve veprojnë në pajtim me parimet e përgjithshme të ligjshmërisë dhe konform autorizimeve, që jepen nga Kryetari i Komunës.
3. Përbërja e Komisionit duhet të jetë prej 5 anëtarëve, njëri nga anëtarët e komisionit duhet të jetë zyrtar i financave dhe një anëtar mund të jetë nga shoqëria civile që ka fushëveprim të ngjashëm me fushën që do të ndahet subvencioni.
4. Kryetari dhe anëtarët tjerë të Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve duhet të jenë shërbyes civil të Komunës, me përrjashtim të anëtarit të shoqërisë civile.
5. Përbërja e Komisionit duhet të bazohet mbi parimin e barazisë gjinore.
6. Anëtarët e Komisionit për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve mbajnë përrgjegjësinë për zbatimin e drejtë të kriterëve për ndarje të subvencioneve.

Neni 8

Vlerësimi i kërkesave dhe vendimmarrja

1. Komisioni bënë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve brenda afatit prej 15 ditë pune pas përfundimit të afatit të shpalljes publike.
2. Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve veprojnë në pajtim me legjislacionin për financat publike dhe dispozitat e kësaj rregulloreje si dhe legjislacionin në fuqi.
3. Rekomandimet e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.
4. Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e tij i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.
5. Komisioni i rekomandon Kryetarit të Komunës listën e përfituesve të subvencioneve në përputhje me kriteret e përcaktuara në shpalljen publike për ndarjen e subvencioneve dhe në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje si dhe i rekomandon marrjen e vendimit për ndarje të subvencioneve.
6. Bazuar në rekomandimin e komisionit, Kryetari merr vendim për ndarjen e subvencioneve dhe brenda pesë ditëve të punës, lista e përfituesve të përzgjedhur publikohet në ueb faqen zyrtare si dhe në tabelën e shpalljeve publike të komunës.
7. Të gjithë aplikuesit njoftohen për te drejtën dhe procedurën e parashtimit të ankesës përmes listës së publikuar.
8. Kërkesat që nuk i plotësojnë kriteret për subvencione do të refuzohen nga Kryetari me rekomandim të Komisionit.
9. Kryetari mund të kërkojë që Komisioni për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve të bëjë rivlerësimin e kërkesave apo të anulojë gjithë procesin e vlerësimit dhe të caktojë komision të ri për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve.
10. Kryetari merr vendim përfundimtar për ndarjen e subvencioneve, në përputhje me rekomandimin e Komisionit, në afat prej 5 ditë pune pas përfundimit të afatit të paraqitjes së ankesave të përcaktuar sipas Nenit 10 të kësaj Rregulloreje.

Neni 9

Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve

1. Kryetari i Komunës emëron komisione me mandat tre vjeçar për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve në përbërje të përfaqësuesve nga fushat specifike.
2. Kryetari dhe anëtarët të Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve duhet të jenë shërbyes civil.
3. Komisioni do të jetë në përbërje prej 3 anëtarëve.
4. Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e saj i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.
5. Një anëtar i Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarjen e subvencioneve duhet të jetë zyrtar ligjor i njësisë përkatëse.
6. Anëtarë të Komisionit për vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve nuk mund të jenë zyrtarët të cilët kanë qenë pjesë e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve.
7. Përbërja e Komisionit duhet të bazohet mbi parimin e barazisë gjinore.

Neni 10

Parashtrimi dhe zgjidhja e ankesave

1. Ankesa parashtrohet në afat prej 5 ditë pune pas njoftimit të vendimit të Kryetarit të Komunës për mos ndarjen e subvencioneve.
2. Komisioni duhet të bëjë shqyrtimin e ankesave dhe të marrë vendim në afat prej 10 ditë pune pas përfundimit të afatit kohor për paraqitje të ankesave.
3. Komisioni për ankesa gjatë vendimmarrjes vepron në bazë të ligjit për procedurën administrative dhe dispozitave të kësaj rregulloreje.
4. Vendimet e Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.
5. Komisioni i ankesave ka të drejtë të:
 - 5.1. të refuzoj ankesën e palëve si te pabazuar; dhe

5.2. të kërkoj nga komisioni vlerësues të rishqyrtoj kërkesat e aplikueseve.

Neni 11

Ekzekutshmëria e vendimit

1. Vendimi i Kryetarit për ndarjen e subvencioneve bëhet i ekzekutueshëm nëse:

1.1. nuk është parashtruar ankesa sipas paragrafit 1 të nenit 10; dhe

1.2. me vendimin e komisionit të ankesave refuzohet ankesa.

Neni 12

Shpallja Publike për ndarjen e subvencioneve

1. Procesi i ndarjes së subvencioneve fillon përmes shpalljeve publike të cilat publikohen në ueb faqen e komunës, mediat lokale, në tabelat e shpalljeve si dhe në vendet e frekuentuara në territorin e komunës.
2. Në shpallje përcaktohen saktë kriteret dhe procedurat për të aplikuar për ndarjen e subvencioneve të cilat përcaktohen sipas kësaj rregullore.
3. Shpallja publike qëndron e publikuar së paku 10 ditë pune nga data e shpalljes.

Neni 13

Marrëveshja për subvencionim

1. Për realizimin e subvencioneve duhet të lidhet një marrëveshje me të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrat mes të komunës dhe përfituesit të subvencionit.
2. Marrëveshja duhet të lidhet në çdo rast kur subvencioni që jepet kalon vlerën mbi **5,000euro**.
3. Marrëveshja e paraparë me pikën 2 të këtij neni nuk aplikohet për subvencionet që jepen për trajtimin e sëmundjeve shëndetësore si dhe për shpërblimin e studentëve, mësimeve dhe sportistëve për sukseset e arritura në garat kombëtare apo ndërkombëtare.
4. Marrëveshja duhet të përcaktojë subjektet nënshkruese të marrëveshjes, qëllimin, shumën e mjeteve financiare, afatet kohore, detyrat dhe përgjegjësitë e palëve, mbikëqyrjen, formën e subvencionimit, raportimin, hyrjen në fuqi si dhe pjesë tjera relevante për marrëveshjen.
5. Marrëveshja duhet të nënshkruhet në afat prej 10 ditë pune pas shpalljes së vendimit përfundimtarë për ndarje të subvencioneve.

Neni 14

Subvencionet për arsim

1. Komuna mund të ndajë subvencione për arsim duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
 - 1.1 Bursa për student;
 - 1.2 Bursa për nxënës në shkollë të mesme;
 - 1.3 Bursa për nxënës në shkollë fillore;
 - 1.4 Kuadrot deficitar;
 - 1.5 Nxënësit me nevoja të veçanta;
 - 1.6 Gara apo kuize (aktivitete jashtë mësimore);
 - 1.7 Botimin e librave/revistave; dhe
 - 1.8 Nxënësit, mësimdhënësit, studentet që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
2. Kategoritë dhe shumat e subvencionimit do të përcaktohen me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës për çdo vit fiskal.

Neni 15

Kriteret dhe dokumentet që nevojiten për ndarjen e bursave

1. Kryetari i Komunës me vendim të veçantë përcakton kriteret të qarta për dhënien e bursave duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në:
 - 1.1 Notën mesatare;
 - 1.2 Numrin e studentëve/nxënësve në familje;
 - 1.3 Kategoritë e dala nga lufta (vetëm për studentë);
 - 1.4 Banimin në zona rurale;
 - 1.5 Rezultatet në gara; dhe
 - 1.6 Gjendjen ekonomike.
2. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të bursave përfshijnë, por duke mos u kufizuar:
 - 1.1 Dokumenti i identifikimit;
 - 1.2 Certifikata e notave;
 - 1.3 Certifikata e vitit kalendarik të studimeve;

- 1.4 Certifikata e vendbanimit;
 - 1.5 Dëshmi mbi gjendjen ekonomike;
 - 1.6 Dëshmi se prindërit janë kategori të dala nga lufta; dhe
 - 1.7 Dëshmi për rezultatet në gara;
3. Aplikuesi nuk mund të jetë përfitues i bursës nëse brenda vitit të njëjtë fiskal ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga pushteti qendror ose ndonjë donatorë tjetër për fushën e njëjtë.
4. Komuna duhet të bëjë shpalljen publike për dhënien e bursave e cila publikohet në ueb faqen e Komunës, në vendet e frekuentuara, mediat sociale dhe në mediat lokale.

Neni 16

Subvencionet për zhvillim ekonomik

1. Komuna mund të ndajë subvencione për zhvillim ekonomik duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
- 1.1 Zejet tradicionale;
 - 1.2 Aksesore;
 - 1.3 Agrobizneset;
 - 1.4 Teknologji Informative;
 - 1.5 Ndërmarrjet publike;
 - 1.6 Bizneset inovative;
 - 1.7 Ndërmarrjet sociale;
 - 1.8 Aktivitetet e shoqatave të cilat ndihmojnë dhe promovojnë zhvillimin ekonomik dhe turizmit;
 - 1.9 Inkubatorët e biznesit;
 - 1.10 Bizneset e reja apo fillestare;
 - 1.11 Aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve njerëzore për zhvillim te biznesit; dhe
 - 1.12 Aktivitetet për hulumtime të tregut të grupeve të studentëve.
2. Përfitues të subvencioneve për zhvillim ekonomik mund të jenë vetëm bizneset që veprojnë në Komunë.

3. Përfitues të subvencioneve për zhvillim ekonomik nuk mund të jenë bizneset që kanë obligime financiare të papaguara komunale dhe ATK-së.

Neni 17

Përparësitë gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillim ekonomik

1. Gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillim ekonomik, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:
 - 1.1 Bizneseve prodhuese, përpunuese dhe shërbyese që krijojnë punësim;
 - 1.2 Grave, të rinjve, zonave rurale, personave me nevoja të veçanta dhe komunitetet;
 - 1.3 Bizneseve që kanë siguruar bashkëfinancim nga palë të treta me një përqindje (%) të caktuar nga vlera e projektit. Përqindja e kërkuar e bashkëfinancimit do të caktohet varësisht nga mundësit buxhetore të komunës;
 - 1.4 Bizneseve të cilat posedojnë dëshmi apo certifikime profesionale;
 - 1.5 OJQ-ve të cilët aplikojnë me projekte biznesi të cilat mundësojnë gjenerim të vendeve të punës; dhe
 - 1.6 Bizneseve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë fiskal nuk kanë qenë përfitues i një subvencionit për zhvillim ekonomik të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.
2. Bizneset e përcaktuara në paragrafin 1.3 dhe 1.4 të këtij neni mund të aplikojnë për ndarje të subvencioneve edhe jashtë periudhës së shpalljes publike me kërkesë të arsyetuar.

Neni 18

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione për zhvillim ekonomik

1. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për zhvillim ekonomik përfshijnë, por duke mos u kufizuar:
 - 1.1 Plani i biznesit;
 - 1.2 Dokumenti identifikues;
 - 1.3 Certificate e vendbanimit (për persona fizik);

- 1.4 Certifikata e biznesit;
- 1.5 Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
- 1.6 Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
- 1.7 Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së;
- 1.8 Dëshmi për bashkëfinancim (nëse ka bashkëfinancim); dhe
- 1.9 Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;

Neni 19

Subvencionet për bujqësi

1. Komuna mund të ndajë subvencione për bujqësi duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
 - 1.1 Projekte të fermerëve, shoqatave, kooperativave bujqësore, në fushat bujqësore me prioritet për Komunën;
 - 1.2 Organizimin e panairove, seminareve, vizitave studimore;
 - 1.3 Mbështetjen e projekteve me bashkëfinancim; dhe
 - 1.4 Projekte në sektorin e pylltarisë.
2. Gjatë ndarjes së subvencioneve në bujqësi, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi:
 - 1.1 Zonave me prioritet të identifikuar nga Komuna;
 - 1.2 Pjesëmarrjes së fermerit në bashkëfinancim me një përqindje (%) të caktuar nga vlera e projektit. Përqindja e kërkuar e bashkëfinancimit do të caktohet varësisht nga mundësit buxhetore të komunës;
 - 1.3 Grave, të rinjve, personave me nevoja të veçanta dhe minoritete; dhe
 - 1.4 Aplikuesëve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë fiskal nuk kanë qenë përfitues i një subvencioni për bujqësi të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.

Neni 20

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione në bujqësi

1. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për bujqësi nga personat juridik përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 1.1 Numri identifikues i fermerit (NIF);

- 1.2 Certifikata e biznesit;
 - 1.3 Projekti dhe plani financiar;
 - 1.4 Fletë posedim për patundshmëri;
 - 1.5 Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
 - 1.6 Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
 - 1.7 Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së;
 - 1.8 Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;
 - 1.9 Dokumenti identifikues i personit të autorizuar për tërheqjen e mjeteve dhe autorizimit.
 - 1.10 Dëshmi se nuk është përfitues i një subvencioni të ndarë nga pushteti qendror në këtë fushë brenda vitit fiskal.
2. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për bujqësi nga personat fizik përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 1.1. Numri identifikues i fermerit (NIF);
 - 1.2. Projekti dhe plani financiar;
 - 1.3. Fletëposedim për patundshmëri;
 - 1.4. Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
 - 1.5. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë; dhe
 - 1.6. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit.

Neni 21

Subvencionet për shëndetësi dhe mirëqenie sociale

1. Komuna ndanë subvencione për banorët rezident për përballimin e shpenzimeve të shërimit sipas kriterëve të përcaktuara nga drejtoria përgjegjëse për shëndetësi.
2. Subvencionet për shëndetësi jepen për:
 - 1.1. Rastet e rënda shëndetësore;
 - 1.2. Rastet e sëmundjeve kronike por pa burim të të ardhurave;
 - 1.3. Trajtimi jashtë vendit;
 - 1.4. Fushatat e vetëdijesimit për shëndetin publik;
 - 1.5. Mirëqenie sociale.

3. Gjatë ndarjes së subvencioneve në shëndetësi, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:
 - 1.1. Numri i anëtarëve të familjes;
 - 1.2. Çështja e banimit;
 - 1.3. Kostoja e trajtimit;
 - 1.4. Gjendja ekonomike familjare;
 - 1.5. Trajtimi në institucionet private (nëse një sëmundje e tillë nuk mund të trajtohet në institucionet publike).
4. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për shëndetësi nga personat fizik përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 1.1 Diagnoza e mjekut specialist;
 - 1.2 Dokumenti i identifikimit;
 - 1.3 Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;
 - 1.4 Dëshmia e shpenzimeve mjekësore;
5. Personat, për subvencionet e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni mund të ndahen edhe pa shpallje publike por me kërkesë të arsyetuar.

Neni 22

Subvencionet për kulturë, rini, sport

1. Komuna mund të ndajë subvencione për kulturë, rini dhe sport duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
 - 1.1. Klubet sportive;
 - 1.2. Sportistët e dalluar;
 - 1.3. Garat sportive;
 - 1.4. Shoqëritë amatore (ansamblet);
 - 1.5. Teatrot amatore;
 - 1.6. Festivalet;
 - 1.7. Botimi i librave;
 - 1.8. Ekspozitat me fotografi;
 - 1.9. Aktivitete me karaktere garuese;

- 1.10. Pjesëmarrje në festivale jashtë komune;
 - 1.11. Promovim i librave;
 - 1.12. Promovim i talenteve të rinjve;
 - 1.13. Aktivitete, kulturore, rinore dhe sportive të organizuara nga DKRS;
 - 1.14. KVRL; dhe
 - 1.15. Qendra Rinore.
2. Gjatë ndarjes së subvencioneve, në kushte të barabarta, Komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:
 - 1.1. Projektet që kanë siguruar bashkëfinancim nga palët e treta sipas vlerës;
 - 1.2. Projektet të cilat mund të krijojnë të hyra financiare për kërkuesin e subvencionit, në funksion të sigurimit të qëndrueshmërisë së projektit për periudhën e ardhshme; dhe
 - 1.3. Aplikuesëve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë fiskal nuk kanë qenë përfitues i një subvencionit për kulturë, rini, sport të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër
3. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve përfshijnë, por duke mos u kufizuar:
 - 1.1. Projekt propozimi;
 - 1.2. Aplikacioni;
 - 1.3. Dokumenti identifikues;
 - 1.4. Certifikata e vendbanimit (për persona fizik);
 - 1.5. Certifikata e regjistrimit (për persona juridik);
 - 1.6. Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
 - 1.7. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë (për persona fizik);
 - 1.8. Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridik);
 - 1.9. Konfirmim nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit.

Neni 23

Raportet kthyes nga përfituesit e subvencioneve

1. Përfituesit e subvencioneve të ndara nga Komuna obligohen që në Komunë të dorëzojnë raport financiar dhe narrativ;
2. Përfituesit e subvencioneve obligohen që pas marrjes së subvencionit të dorëzojnë në komunë raportin me të gjitha shpenzimet financiare ashtu siç janë kërkuar me projekt-propozim. Raporti duhet t'i ketë të gjitha shpenzimet e dokumentuara (raportet bankare, faturat e rregullta, nënshkrimet e pjesëmarrësve etj.);
3. Përfituesit e subvencioneve obligohen që pas përfitimit të subvencioneve të dorëzojnë raportin narrativ i cili duhet t'i ketë të gjitha të dhënat e aktiviteteve që janë realizuar gjatë zbatimit të projektit;
4. Periudha kohore e raportimit duhet të jetë 15 ditë pune pas përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në marrëveshjen në mes palës përfituese dhe komunës apo në vendimin e Kryetarit të Komunës;
5. Raportet nga paragrafi 1 i këtij neni protokollohen dhe një kopje e tyre dorëzohet në arkivin e komunës.

Neni 24

Monitorimi i përfituesve të subvencioneve

1. Komuna ka të drejtë të iniciojë auditimin e përfituesve për mënyrën e shpenzimit të mjeteve të ndara nga komuna në formë të subvencioneve;
2. Komuna mund të bëjë monitorimin e përfituesve të subvencioneve, me theks të veçantë të përfituesve në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik, në lidhje me shfrytëzimin e drejtë dhe sipas vendimit apo marrëveshjes të mjeteve të ndara në formë të subvencioneve;
3. Monitorimi sipas paragrafit 2 mund të bëhet në periudhën kohore deri në 3 vite nga data e përfitimit të subvencionit.

Neni 25

Transparenca në ndarjen e subvencioneve

1. Komuna publikon listën përfundimtare të përfituesve të subvencioneve brenda 5 ditë pune pas vendimit për ndarje të subvencioneve nga Kryetari.
2. Lista përfundimtare e përfituesve duhet të përmbajë: emrin e përfituesit, rastin, fushën për të cilën jepet subvencioni dhe shumat që iu janë ndarë.

3. Përfundimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, komuna nuk i publikon subvencionet për rastet e përcaktuara në paragrafët 2.1, 2.2, 2.3, të nenit 21.
4. Publikimi i vendimeve dhe i përfituesve nga ndarja e subvencioneve bëhet në ueb-faqen e Komunës, në tabelat e shpalljeve si dhe në vendet e frekuentuara në territorin e Komunës.

Neni 26

Dispozitat transitorë dhe shfuqizuese

1. Ndarja e subvencioneve e filluar para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje vazhdon me rregullativën ekzistuese pavarësisht nëse kjo rregullore hyn në fuqi.

Neni 27

Hyrja në fuqi



Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pune pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe pas publikimi në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Data: 31.10.2018

Kryesuesi i Kuvendit:

Muhamet Krasulqi





**REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK**

**Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/30;
Datë: 31.10.2018 .**

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 8 paragrafi 1. të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Ligji Nr. 04/L-144, GZRK numër 35/17); dhe nenit 22 paragrafi 4. të Statutit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.10.2018 nxjerrë:

V E N D I M

për

themelimin e Komisionit Vlerësues për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës së Junikut në Shfrytëzim

I. Me këtë vendim themelohet Komisionit Vlerësues për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës së Junikut në Shfrytëzim /në tekstin e mëtejme komisioni/.

II. Komisioni nga pika I. e këtij vendimi do të përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë (neni 8 paragrafi 2. i Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës), 3 (tre) anëtarë propozohen nga ana e ekzekutivit të Komunës së Junikut, 3 (tre) anëtarë propozohen nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe 1 (një) anëtar propozohet nga shoqëria civile.

1. Albert Gjocaj AAK-PDK,
2. Xhemë Tofaj AAK-PDK,
3. _____ LDK-LVV,
4. Arton Krasniqi- nga ekzekutivi,
5. Turim Ganiqaj - nga ekzekutivi,
6. Shpejtim Kuqi - nga ekzekutivi,
7. Elbasan Qestaj - nga shoqëria civile.

III. Propozimet nga pika II. e këtij vendimi i procedohen Kuvendit të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe miratim.

IV. Mandati i anëtarëve të komisionit nga pika I. e këtij vendimi është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Junikut.

V. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit janë:

1. Zgjedhja e kryetarit të komisionit;
2. Hartimi i njoftimit publik me të dhënat për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim;
3. Prezenca në ankand publik (hapjen publike të ofertave);
4. Vlerësimi final i ofertave më të favorshme ekonomikisht për komunën në përputhje me kriteret e përcaktuara me njoftimin për ankand publik dhe shprehje të interesit;
5. Procedimi për shqyrtim dhe miratim i ofertës më të favorshme të për zgjedhur nga ana e komisionit në Komunën e Junikut; dhe
6. Detyra të tjera të cilat konsiderohen të rëndësishme nga ana e komisionit dhe nuk janë të përcaktuara me këtë vendim.

VI. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen vendimet tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.



VII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
4. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/31
Datë: 31.10.2018 .

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2. pika d); nenit 14 paragrafi 2. pikat a), b), c) dhe e) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 7 paragrafi 3. të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Ligji Nr. 04/L-144, GZRK numër 35/17); dhe nenit 19 paragrafi 2. të Statutit të Komunës së Junikut, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.10.2018 nxjerrë:

V E N D I M P A R A P R A K

për

Dhënien në shfrytëzim afatshkurtë të pronës së paluajtshme komunale

- I. Me këtë vendim miratohet vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtë të pronës së paluajtshme komunale.
- II. Me këtë vendim lejohet shprehja e interesit në pronën e paluajtshme të komunës në Parcelën kadastrale numër 1174-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 7633 m² në vendin e quajtur Bajraktar-Varrezat e Imer, kultura – tokë jo pjellore, shfrytëzimi aktual – jo pjellore.
- III. Parcelat kadastrale nga pika II. e këtij vendimi janë pronë komunale dhe evidentohen në Certifikatat e pronësisë numër P-73105038-01174-0 .
- IV. Sipërfaqja nga pika II. e këtij vendimi jepet në shfrytëzim afatshkurtë prej 15 (pesëmbëdhjetë) vitesh përmes konkursit të hapur publik sipas kriterëve të përcaktuar me Ligjin Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
- V. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës nga pika II. e këtij vendimi është ruajtjen e sistemeve ekologjike, studimin e llojeve të specieve dhe habitateve, etj.
- VI. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut, Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Komisioni për Ankesa.
- VII. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi pushojnë së vlejti të gjitha vendimet e mëparshme me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

IX. Arsyetim:

Lejimi për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtë sipas këtij vendim është me interes publik vital për zhvillimin e komunës së Junikut, respektivisht plotësimin e nevojave të nxënësve dhe studiuesve të fushave të ndryshme nga kjo lëmi, me çka do të krijoheshin kushte për punësim dhe zhvillim ekonomik të komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës;
4. Komisioni për Ankesa;
5. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
6. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi

